



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 162 prot.

Kamëz, më 18. 12. 2023

V E N D I M

Nr 117 Datë 18 / 12 / 2023

PËR

“TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KAMËZ TË PASURISË NR.331/15/
PJESË E LISTËS SË INVENTARIT TË ISH-KOMUNËS PASKUQAN”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 18.12.2023, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.89 Datë 13.12.2023, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.8743, datë 22.01.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të VKM-së nr.28, date 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, të VKM-së nr. 454, datë 22.06.2011 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Paskuqan , të Qarkut Tiranë” dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.351, datë 06.06.2023 “Mbi ngritjen e Grupit të Punës për verifikimin, saktësimin, inventarizimin dhe plotësimin e pronave shtetërore të transferuara në pronësi të Bashkisë Kamëz si dhe të pronave që nuk janë transferuar me VKM”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Miratimi i kërkesës për propozim për kalimin në pronësi të Bashkisë Kamëz, të pasurisë nr.331/15/ (sipërfaqen e lirë), të pasqyruar në fletën e inventarit të ish-Komunës Paskuqan me numër rendor 190, me sipërfaqe 1213 m² sipas planit të rilevimit, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, drejtuar organeve kompetente.
2. Pas miratimit të vendimit, ndjek zbatimin e tij Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave dhe Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI